



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo unutaršnjih poslova - Ministry of
Internal Affairs

DOKUMENT KONSULTIMI

PËR

PROJEKTLIGJIN PËR PAGAT

NË

SEKTORIN PUBLIK

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E PROJEKT LIGJIT PËR PAGAT NË SEKTORIN PUBLIK

Problemet kryesore të cilat i adreson Projektligji për Pagat

Situata aktuale sa u përket pagave që realizohen nga buxheti i shtetit ka krijuar një situatë komplekse për shtetin e Kosovës. Kjo situatë është si rezultat i një numri relativisht të lartë të akteve të veçanta ligjore dhe nënligjore, apo edhe vendimeve me të cilat rregullohen dhe përcaktohen niveli i pagave dhe kompensimeve. Sistemi aktual i pagave në sektorin publik është i fragmentuar dhe në këtë mënyrë vlerësohet se është edhe i paefektshëm, sepse nuk është i ndërtuar mbi parime

Projektligji për Pagat (tash e tutje referuar si “Projektligji”) ka për qëllim kryesor përcaktimin dhe rregullimin e sistemit të pagave dhe shpërblimeve për të gjithë të punësuarit që përfitojnë pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Nga kjo kategori e cila mbulohet me këtë projektligj përjashtohet vetëm Agjencia Kosovare e Inteligjencës, për arsye se ka natyrë tejet specifike të punës.

Projektligji, përmes sistemit të pagave që synon të krijojë, do të rregullojë edhe mënyrën dhe kushtet e pagesës për kategoritë të cilat i rregullon. Në fakt, ky projektligj përjashton mundësitë që mënyra dhe kushtet për pagë dhe shpërblime të rregullohen me akte tjera normative përveç kur parashihet dhe autorizohet shprehimisht me këtë projektligj.

Projektligji ngrit sistemin e pagave mbi parime të përdorura nga praktikantët më të mira ndërkombëtare. Për më tepër, këto parime janë në përputhshmëri me zgjidhjet e kërkuara për t[dalë nga situata aktuale ku janë përdorur sisteme të ndryshme të pagave në mungesë të qasjes parimore. Përkatësisht, ky Projektligj përcakton se parimet në vijim paraqesin parimet mbi të cilat është rregulluar sistemi i pagave:

- parimi i ligjshmërisë i cili nënkupton se e drejta në pagë përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij Projektligji dhe me aktet nënligjore, të autorizuara dhe të nxjerra në zbatim të tij. Ky parim tregon se në përcaktimin e të drejtës në pagë do të aplikohet një sistem uniform i vlefshëm për të gjithë punonjësit që përfitojnë pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Për më tepër, ky parim përcakton se pagesat duhet të kenë bazën ligjore konform rregullave të përcaktuara me këtë Projektligj. Kështu, duke siguruar që e drejta në pagë e punonjësve realizohet konform sundimit të ligjit;
- parimi i transparencës i cili nënkupton që përcaktimi i pagave dhe të drejtave të tjera që burojnë nga paga, është informacion me interes publik në pajtim me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale;
- parimi i parashikueshmërisë në këtë Projektligj paraqitet në dy situata. Së pari, nënkupton që përfituesit e pagave sipas këtij Projektligji duhet të kenë pritshmëri të ligjshme që niveli i pagës i përcaktuar sipas këtij ligji, nuk mund të ulet përveç në situatë të jashtëzakonshme të vështirësive financiare dhe vetëm në bazë të ligjit. Së dyti, i përgjigjet edhe periudhës tranzitore në rastet kur aplikohet për pagat të cilat parashihet të nivelizohen me këtë Projektligj. Kështu, ky parim është mishëruar në dispozitat e këtij Projektligji me qëllim për të rezultuar, ndër të tjera, në respektimin e parimit të sigurisë juridike.

- Parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit i cili nënkupton se në përfitim të pagës, të gjithë janë të barabartë dhe gëzojnë pa asnjë diskriminim. Ky parim, për më tepër është në linjë me legjislacionin përkatës për mbrojtje nga diskriminimi. Projektligji definon edhe më tej këtë parim duke treguar se të gjithë kanë të drejtë që për punë të barabartë të marrin pagë të barabartë. Ky parim është aplikuar konform Aktgjykimit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin nr. KO219/19 (*parashtrues Avokati i Popullit – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. ç6/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, 9 korrik 2ç2ç*). Përkatësisht, gjatë trajtimit të këtij parimi, ky Projektligj merr parasysh faktorë si natyra e punës, institucionin në të cilin ushtrohet detyra, edukimin dhe trajnimin përkatës që kërkohet, si dhe kushtet tjera të punës.

Qëllimi i konsultimit

Qëllimi i konsultimit publik është që t'i mundësohet të gjitha palëve që të kontribuojnë me sugjerimet dhe komentet e tyre lidhur me Projekt Ligjin për Pagat.

Fillimisht, Ministria e Punëve të Brendshme ka themeluar një grup punues i cili ka analizuar të gjitha mangësitë dhe anomalitë e ligjit të shfuqizuar, aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe ka ofruar shembuj të praktikave të mira të cilat do të mund të shërbenin në hartim të këtij ligji. Më pas, është themeluar grupi punues i projekt-ligjit për paga, i cili ka bërë punën substanciale në ligj. Përgjatë hartimit të Projektligjit janë ftuar dhe konsultuar të gjitha institucionet e administratës publike.

Po ashtu, Ministria e Punëve të Brendshme sipas dispozitave të Nenit 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr.09/2011, ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake ku i është dërguar drafti të gjitha institucioneve për konsultime paraprak.

Në këtë fazë, Ministria e Punëve të Brendshme është e përkushtuar që të krijoj hapësirë të nevojshme dhe të mjaftueshme për konsultime publike, Platformën Elektronike për konsultimet publike, dhe mirëpret veçanërisht kontributin në përmirësimin dhe avancimin e këtij Projektligji nga të gjitha institucionet

Në këtë drejtim, kontributi pritët edhe nga ana e organizatave të shoqërisë civile, ekspertë përkatës dhe qytetarët në përgjithësi, organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe ekspertët të ndryshëm të asistencës teknike nga donatorët në institucionet e Republikës së Kosovës.

Të gjitha komentet, rekomandimet, alternativat tuaja të propozuara lidhur me Projektligjin për Pagat në Sektorin Publik si institucion propozues, do t'i analizojmë dhe shqyrtojmë në afatin sa më të shkurtër.

Pas përfundimit të draftit përfundimtar së bashku me tabelën informuese, do t'ua përcjellim të gjitha grupeve të përfshira në konsultim.

Afati përfundimtar për dorëzimin e përgjigjeve

Afati përfundimtar i dorëzimit të kontributit me shkrim në kuadër të procesit të konsultimit publik të këtij Projektligji është 15 ditë pune duke filluar nga dita e publikimit.

Të gjitha komentet e pranuar deri në këtë afat do të përmbliidhen nga ana e zyrtarit përgjegjës për hartimin e këtij Projektligji

Të gjitha komentet me shkrim duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën:

meliza.gorraj@rks-gov.net dhe mpb.dl@rks-gov.net

me titull “Komente nga (**emri i institucionit tuaj**) lidhur me Projektligjin për Pagat në Sektorin Publik”

Ju lutemi që në kuadër të kontributit tuaj me shkrim, të specifikoni qartë se në çfarë cilësie jeni duke kontribuar në këtë proces konsultimi (p.sh. në cilësi të përfaqësuesit të organizatës, kompanisë, në cilësi individuale, etj.)

Komentet nga organizatat

Ju lutem, që komentet tuaja të ofrohen sipas udhëzimeve të shënuara më poshtë.

Emri i organizatës që jep komente:

Fushat kryesore të veprimit të organizatës:

Informatat e kontaktit të organizatës (adresa, e-mail, telefoni):

Data e dërgimit të komenteve:

Forma e kontributit është e hapur.

Bashkëngjitur me këtë dokument, gjeni:

1. Projektligji për Pagat në Sektorin Publik;
2. Memorandumi Shpjegues.